

**AKT THEMELIMI  
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
New York Taxi SHPK**

Sot më datë 17.08.2022, u paraqit personalisht:



**z. Adem Belliu**, atësia Yzedin, amësia Mynevere, shtetas amerikan, lindur në Rrapëz, Lushnjë dhe banues në 2509 Paulding ave Fl 1 Bronx NY 10469 , lindur më 01/04/1959, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar mbajtes I pasapoertes amerikane nr. 51704757.

Ne baze te Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe Shoqëritë tregtare" dhe ne ligjit Nr. 9723, date 03.05.2007 për Q.K.B, kërkoi redaktimin e Aktit te Themelimit dhe Statutit te Shoqërisë me përgjegjësi te kufizuara si me poshtë vijon:

**NENI I  
EMERTIMI I SHOQERISE**

- 1.1 Emri i shoqërisë është " New York Taxi " Shpk (me poshtë e quajtur "Shoqëria").

**NENI 2  
SELIA LIGJORE**

- 2.1 Selia e Shoqërisë ndodhet ne adresë:Tirane , Rruga Him Kolli, P. Kris, Ap.,1.  
2.2 Asambleja e Përgjithshme mund te vendose mbi transferimin e selisë se Shoqërisë ne një adresë tjeter. Organi administrues i Shoqërisë mund te themeloje ose mbylle dege dhe/ose zyra përfaqësimi, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës se Shqipërisë.

**NENI 3  
KOHEZGJATJA**

- 3.1 Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin e saj per një periudhe te pacaktuar.

**NENI 4  
OBJEKTI I SHOQERISE**

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "New York Taxi" shpk e ushtron aktivitetin e saj me objektin e mëposhtëm:

- 4.1 Transportin e personave brenda dhe jashtë territorit te Republikës se Shqiperise

4.2 Shoqeria do te kryeje çdo veprimtarie te lejuar nga ligji dhe/ose pjesemarrjen ne çdo veprim apo aktivitet te ligjshem qe mund te kryeje nje shoqeri me perjegjesi te kufizuar, e krijuar ne baze te legjisacionit shqiptar.

## **NENI 5** **KAPITALI I SHOQERISE**

- 5.1 Kapitali i Shoqërisë është 105 000 euro.Pref të cilave 20% do të bëhen parapagim brenda këtij viti. Pjesa tjeter deri brenda vitit 2023.
- 5.2 Të gjitha pjesët e kapitalit themeltar janë nënshkruar dhe shlyer plotësisht nga Ortaku themelues.
- 5.3 Ne rast zmadhimi apo zvogëlimi te kapitalit themeltar te Shoqërisë, ortaku do te kenë te drejtën e nënshkrimit te zmadhimit apo zvogëlimit te kapitalit ne përpjesëtim te drejte me pjesemarrjen qe zotëron ne kapitalin e Shoqërisë.

## **NENI6** **KALIMI I KUOTES ME TRASHEGIMI (MORTIS CAUSA) OSE PER SHKAK TE FALIMENTIMIT TE ORTAKUT**

- 6.1 Kuotat e Ortakëve mund të transferohen lirisht tek trashëgimtarët ligjorë e testamentarë të tyre mbas vdekjes. Ortaku e mbetur mund të ushtrojnë të drejtën e parablerjes në rast shitje të të njëjtave si pasojë e mungesës se vullnetit të trashegimtarëve për të hyrë në vend të vdekurit

## **NENI 7** **ZMADHIMI DHE ZVOGELIMI I KAPITALIT**

6.2.Organi vendimarres per zmadhimin dhe zvogelin e kapitalit te regjistruar te shoqerise eshte Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve.

6.3.Kapitali I shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjeseve te kapitalit themeltar per kontributet ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre permes emerimit nga gjykata kompetente te nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kerkeses se administratorit .

Ne asnjë rast shumica nuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin themeltar te shoqerise por vete ortaku pranon rivleresimin e pjeses se tij takuese ne shoqeri ne proporcione me rritjen e kapitalit.

Zvogelimi I kapitalit lejohet nga asambleja e pergjithshme e ortakeve e cila merr vendim ne te njejtat kushte qe kerkohen per ndryshimin e statutit.

Ne te gjitha rastet zvogelimi I prek ortaket ne te njeften mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqesojne.



**NENI 8**  
**ASAMBLEJA E PERGJITHSHME**

- 8.1 Asambleja e Përgjithshme është organi vendimmarrës i Shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme vend ose mbi te gjitha çështjet për te cilat është kompetente sipas ligjeve ne fuqi ne Republikën e Shqipërisë, sipas këtij Akt Themelimi dhe Statuti dhe/ose çdo marrëveshje midis ortakeve te Shoqërisë.
- 8.2 Çdo ortak ka te drejte te marre pjese ne mbledhjet e Asamblesë se Përgjithshme, te shprehe vullnetin e tij si dhe te votoje ne përputhje me pjesët e kapitalit qe ai zotëron ne Shoqëri.
- 8.3 Çdo ortak mund te përfaqësohet nga një ortak tjetër ose nga një person tjetër, me prokure me shkrim .
- 8.4 Mbledhja e Asamblesë se Përgjithshme mund te mbahet brenda ose jashtë territorit te Republikës se Shqipërisë. Ortaket ose përfaqësuesit e autorizuar mund te marrin pjese ne mbledhjen e Asamblesë se Përgjithshme nëpërmjet mjeteve elektronike, përfshire telekonferencën (konferencë call) audio ose video, ne përputhje me ligjin për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare dhe ligjin për komunikimet elektronike. Mbledhja e Asamblesë se Përgjithshme do te quhet e mbajtur ne vendin ku ndodhet Kryetari i saj dhe Sekretari i mbledhjes, me qellim qe te hartohet dhe te nënshkruhet procesverbali përkatës.
- 8.5 Asambleja e Përgjithshme mund te thirret nga Administratoret ose nga ortaket ne baze te nenit 84 te ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 "Mbi ndërmarrjet dhe shoqëritë tregtare". Thirja e mbledhjes se Asamblesë se Përgjithshme duhet te behet nëpërmjet njoftimit me shkrim ose mjete elektronike, dërguar secilit prej ortakeve ne adresat e njoftuara Shoqërisë te paktën 7 (shtate) dite përpëra datës se caktuar për mbledhjen e saj. Njoftimi duhet të përmbaje rendin e ditës, vendin, datën dhe orën e mbledhjes. Asambleja e Përgjithshme do te mblidhet rregullisht, pavarësisht nga këto formalitete, kur ortaket apo përfaqësuesit e tyre janë te pranishëm dhe bien dakord te vendosin ne lidhje me rendin e ditës.
- 8.6 Mbledhjet e Asamblesë se Përgjithshme kryesohen nga Administratoret. Asambleja e Përgjithshme cakton një sekretar për çdo mbledhje nder personat e pranishëm.
- 8.7 Vendimet e Asamblesë se Përgjithshme duhet te jene me shkrim dhe te firmosen nga kryetari dhe sekretari. Me kërkesë te ortakeve, vendimet duhet te përfshijnë dhe deklaratat apo vërejtjet e tyre.
- 8.8 Asambleja e Përgjithshme mblidhet te paktën një here ne vit, brenda 6 (gjashte) muajve nga mbyllja e vitit finanziar.
- 8.9 Asambleja e Përgjithshme, përvçse për sa parashikon neni 9.10 i këtij Akti Themelimi dhe Statuti, për vendime qe kërkojnë shumicën e zakonshme, merr vendime te vlefshme vetem nëse marrin pjese ortaket me te drejte vote ose përfaqësuesit e tyre, qe zotërojnë me shume se 30% (tridhjete për qind) te

kapitalit te Shoqërisë, sipas nenit 86 pika I, te Ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 "Mbi ndërmarrjet dhe shoqëritë tregtarë".

8.10 Asambleja e Përgjithshme vendos me votat pro te te paktën 51 % te ortakeve pjesëmarrës (shumica e kualifikuar) ne baze te nenit 87 pika I, te Ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 "Mbi ndërmarrjet dhe shoqëritë tregtarë", per ndryshimin e ketij Akt Themelimi dhe Statuti, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit te Shoqërisë, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë.

## NENI 9 ADMINISTRIMI I SHOQERISE

9.1 Shoqëria administrohet nga Administratori/et i cili/te cilët për një periudhe prej maksimumi 5 (pese) vjetësh. Administratori/et mund te rizgjidhen dhe shkarkohen ne çdo kohe nga Asambleja e përgjithshme. Aktualisht Asambleja e Përgjithshme administrohet nga 1 administrator:

Znj. Vojsava Karafili, atësia Agron, amësia Rita, shtetase Shqiptare, lindur në Tepelenë dhe banues në TIRANË, me adresë Kongresi I Manastirit; Nd. 212; H. 1; Njësia Administrative Nr. 4; Njësia Bashkiake Nr. 4; 1005; Tiranë, lindur më 27/06/1985, gjendja civile "e martuar", madhere, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 033885420 dhe nr. personal I55627058W, .

9.2 Administratori/t zotëron kompetenca te plota ne lidhje me administrimin e Shoqërisë dhe mund te kryeje te gjitha aktet qe konsideron te nevojshme për realizimin e objektit te Shoqërisë përvèç veprimeve si me poshtë, përbushja e te cilëve i rezervohet vetëm Asamblesë se Përgjithshme apo organeve te tjera te Shoqërisë.

- Lëshimi i garancive ose dorëzanisë si garanci e detyrimeve te te treteve;
- Marrja përsipër e financimeve ose huave hipotekare dhe ne formën e hapjes se një kredie;
- Blerje dhe cedime te pjesëmarrjeve ne shoqëri;
- Lidhje kontratash për një shume me te madhe se 20 000,00 (njezet mijë/00) euro e për një shume mujore maksimumi 30 000,00 (tridhjete mijë/00) euro;
- Pagesa për një shume te përditshme me te madhe se 10 000,00 (dhjete mijë/00) euro e për një shume mujore 30 000,00 (tridhjetë mijë/00) euro.

Administratori është përgjegjës për veprimet e kryera gjate administrimit te Shoqërisë dhe mund te autorizoje persona te trete, për te përbushur veprime te caktuara, ne emër dhe për llogari te Shoqërisë. Ne çdo rast, administratori do te jete përgjegjës për veprimet e te tretëve te autorizuar.

9.3 Asambleja e Përgjithshme vendos shpërblimin e administratoreve te shoqërisë

- 9.4 Administratoret do te veprojnë ne çdo kohe vetëm ne interesin me te mire te Shoqërisë. Ne rast konflikti interes, Administratori do te njoftoje menjëherë ortaket si dhe do te heqë dore nga çdo veprim qe lidhet me objektin e konfliktit te interesit deri ne marrjen e udhëzimeve nga Asambleja e Përgjithshme.

## **NENI 10 VITI FINANCIAR**

Viti Financiar i Shoqërisë fillon dhe mbaron me 31 Dhjetor te çdo viti.

## **NENI 11 KONTROLI FINANCIAR**

Kontrolli financiar i Shoqërisë kryhet nga Eksperte Kontabël te Autorizuar, sipas legjisacionit shqiptar ne fuqi. Asambleja e Përgjithshme do te emëroje një apo me shume Eksperte Kontabël te Autorizuar ne atë raste kur emërimi i tyre konsiderohet i nevojshëm ose kërkonhet ne baze te ligjit.

## **NENI 12 BILANCI VJETOR**

- 12.1 Bilanci vjetor, pasqyrat financiare, raportet e organit administrativ mbi ecurinë e veprimtarisë sociale dhe te Ekspertit Kontabël te Autorizuar (nëse janë emëruar) miratohen nga Asambleja e përgjithshme .
- 12.2 Dokumentet qe kane te bëjnë me vitin financiar miratohen nga Asambleja e Përgjithshme brenda 6 (gjashte) muajve nga mbyllja e vitit financiar.

## **NENI 13 DIVIDENDET**

Ne përputhje me dispozitat ligjore, Asambleja e Përgjithshme vendos mbi shpërndarjen e dividendëve ne baze te rezultatit financiar te shoqërisë.

## **NENI 14 ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE**

Mosmarrëveshjet qe mund te lindin ndërmjet Shoqërisë dhe ortakeve, administratoreve, likuiduesit, do t'i nënshtronhen juridiksionit te Gjykatës se Rrethit Gjyqësor Tirane.

## **NENI 15 GJUHA**

Ky Akt Themelimi dhe Statut hartohet dhe nënshkruhet ne 4 (katër) ekzemplare ne gjuhen shqipe.

**NENI 16**  
**DISPOZITA PERFUNDIMTARE**

Shoqëria do te kryeje veprimtarinë e saj ne përputhje me ketë Akt Themelimi dhe Statut dhe ne përputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi. Për sa nuk parashikohet ne ketë Akt Themelimi dhe Statut, do te zbatohen parashikimet e ligjit nr. 9901 i datës 14.04.2008 "Mbi ndërmarrjet dhe shoqëritë tregtare".

**ORTAK I SHOQERISE**

**ADEM BELLIU**

*Adem Belliu* 



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË  
NOTER GJERGJ R. KONGOLI**



V2022053630276411645

**DATE 17/08/2022  
NR REP 4424**

**VËRTETIM NËNSHKRIMI**

Sot, më datë 17.08.2022, para meje Noter GJERGJ R. KONGOLI, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NJESIA ADMINISTRATIVE NR. 10, RR. MIHAL DURI, u paraqit personalisht:

**NËNSHKRUUES:**

**Adem Belliu**, atësia Yzedin, amësia Mynevere, shtetas amerikan, lindur në Rrapëz, Lushnjë dhe banues në 2509 Paulding ave Fl 1Bronx NY 10469, lindur më 01/04/1959, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar mbajtes I pasaportes amerikane nr. 51704757.


I lartpermenduri, u paraqit para meje Noterit dhe nenshkroi Akt Themelimin e Shoqerise 'New York Taxi' shpk.

Unë Noteri, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gëрма “ë”, si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 “Për Noterinë”, dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887; datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave Personale”, unë noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**NOTER**

**GJERGJ R. KONGOLI**



# We the People

Of the United States,  
in Order to form a more perfect Union,  
establish Justice, insure domestic Tranquility,  
provide for the common defense,  
promote the general Welfare, and secure  
the Blessings of Liberty to ourselves and  
our posterity; do ordain and establish this  
Constitution for the United States of America.

